

Newsletter

Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Janar- Prill ka marrë 28 vendime:

- Marrëveshje të ndaluara: **3 vendime**;
- Abuzim me pozitën dominuese: **3 vendime**;
- Përqendrime: **18 vendime**;
- Vendime të tjera: **4 vendime**.



Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

1

Marrëveshje e ndaluar

Tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure

Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 874, datë 25.03.2022, vendosi për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, dhe gjobitjen e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK në shumën 118,978,015 Lekë, ndërmarrjes MBM SHPK në shumën 66,088,573 Lekë, dhe ndërmarrjes CACA SHPK në shumën 7,087,994 Lekë për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.

Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 878, nr. 879, nr. 880, datë 15.04.2022, vendosi rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK, ÇAÇA SHPK, dhe MBM SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.

Nga vlerësimi i kërkesave së tre ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, ÇAÇA SHPK dhe MBM SHPK dhe i argumenteve të dhëna nga këto ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", kërkesat e ndërmarrjeve nuk përmbushin asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

2**Abuzim me
pozitën
dominuuese****Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza”**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 856, datë 22.01.2022, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).

Ndërmarrja Star Parking SHPK ka pozitë dominuese në aktivitetin ekonomik për ofrimin e shërbimit të parkimit me pagesë pranë TIA. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka pozitë dominuese duke patur 100% të tregut përkatës. Duke u bazuar në ligj dhe në udhëzimin përkatës të pozitës dominuese, por edhe në praktikat më të mira të Komisionit Evropian dhe të OECD, monopoli, në këtë rast Star Parking Albania SHPK, mund të shkaktojë potencialisht kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2021.

3**Përqendrim**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 855, datë 14.01.2022 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përfitimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë ALBTELECOM SHA nga shoqëria 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG”, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përfitimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom SHA nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

**Aktivite ndërkombëtare**International
Competition
Network

Rjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN) në bashkëpunim me Këshillin Administrativ të Brazilit për Mbrojtjen Ekonomike CADE në datat 29 mars- 1 prill, zhvilloi workshopin vjetor për përqendrimet i cili u mbajt në Salvador, Brazil. Autoriteti i Konkurrencës u përfaqësua nga Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, Z. Denar Biba. Në këtë workshop u diskutuan temat aktuale të lidhura me përqendrimet dhe efektet pas pandemisë, përfshirë dhe sfidat e fundit me të cilat janë përballur autoritetet dhe zgjidhjet e reja dixhitale.

ICN është rrjeti më i rëndësishëm i autoriteteve të konkurrencës në mbarë botën. Ai përfshin 140 agjenci konkurrence dhe ofron një forum për shkëmbimin e përvojës.

ICN në bashkëpunim me Zyra Federale të Kartelit, në datat 4 – 6 maj 2022, zhvilloi Konferencën e 21-të Vjetore të ICN-së, e cila u mbajt në Berlin, Gjermani.

Autoriteti i Konkurrencës u përfaqësua nga Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, Z. Denar Biba. Konferenca Vjetore është një nga eventet kryesore dhe eventi më i rëndësishëm i vitit për ICN-në. Në këtë konferencë globale u diskutuan tema aktuale të lidhura me të ardhmen e rrjetit të konkurrencës duke ofruar mundësi për të diskutuar rreth eksperiencave, metodologjive dhe projekteve të grupeve të punës dhe zbatimin e tyre.

